

SYLLABUSI I LËNDËS – RELIGJIONI DHE ÇËSHTJET SOCIALE NË EVROPË

Lënda:	Religjioni dhe çështjet sociale në Evropë
Programi i studimit:	Teologjia Islame në kontekstin Evropian MA
Numri i ECTS kredive:	5
Statusi i lëndës:	Obligative
Kodi i lëndës:	510
Fondi i orëve:	2+1
Viti akademik:	2025/2026
Semestri:	I-rë
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Ferdi Kamberi
Kontakti:	ferdikamberi04@gmail.com

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I LËNDËS

Përmes këtij kursi studimi, studentët do të jenë në gjendje të aftësohen dhe të zhvillojnë diapazonin e diturisë me kronologjinë historike të religjionit, llojet e besimeve dhe religjioneve, etapat e zhvillimit të religjionit, kulteve dhe magjisë, format e organizimit, religjioni në Evropë dhe më tej. Gjithashtu, studentët përmes kursit do të marrin njohuri të përgjithshme mbi ndarjen dhe mënyrën e organizimit të religjioneve: religjioneve politeiste dhe religjioneve monoteiste në botë dhe Evropë, raportin në mes të nacionalizmit dhe religjionit rastet në Ballkan dhe më gjerë, konfliktet dhe religjioni, toleranca dhe diversiteti fetar tek shqiptarët, roli i Rilindjes Kombëtare në promovimin e bashkëjetesës fetare, si dhe një mori të nëntemave tjera.

QËLLIMI

Ky kurs ka për qëllim që të: Zhvillojë mendimin kritik rreth analizës së krahasimit në mes të feve politeiste dhe monoteiste; Shqyrtimi i teorive shkencore mbi religjionin, botëkuptimin religjioz dhe komparacionin në mes tyre; Aftësimin rreth njohurive të botëkuptimit historik, kulturor, psikologjik dhe social të feve botërore dhe evropiane; Kultura, mënyra e jetesës dhe traditat fetare sipas fazave të ndryshme; Zhvillimi i njohurive të studentëve mbi rolin e Rilindjes Kombëtare tek shqiptarët në promovimin e bashkëjetesës dhe tolerancës fetare; Aftësimin e studentëve rreth religjionit, mënyrës së organizimit, diversitetit dhe tolerancës fetare në Kosovë.

REZULTATET E PRITURA

Pas përfundimit të kursit, studentët do të jenë në gjendje të:

- Reflekojnë rreth botëkuptimit të religjioneve botërore;
- Organizimit, hierarkisë dhe ndarjes së organizatave fetare;
- Njohuri mbi raportin në mes të nacionales dhe religjiozes – modele në Evropë dhe Ballkan;
- Kuptimi i kronologjisë historike mbi bashkëjetesën dhe diversitetin fetar në Kosovë dhe vendet e rajonit;
- Njohuri dhe zgjerim të diapazonit të diturisë mbi raportin në mes të religjionit, mitit, tabusë dhe kulturës.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15

Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	2	10	20
Detyra të shtëpisë	2	2	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	5	10
Përgatitja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	10	20
Projektet, prezantimet ,etj	3	10	30
Totali			f100 orë / 5 ECTS

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

- Metodologjia e mësimdhënies do të zhvillohet përmes ligjëratave të hapura dhe bashkëpunuese me studentë, do të përdoret metoda e ligjërimit, interaktivit me studentët, do të ketë prezantime dhe kuize.

VLERËSIMI

Vlerësimi do bëhet në sipas aktiviteteve të poshtëshënuara:

- Punimi seminarik 5%
- Pjesëmarrja në ligjërata dhe interaktivi 5%
- Kolektiviumi 20%
- Punimi përfundimtar 70%

LITERATURA BAZË

1. Meredith B. McGuire: “Religjioni në kontekstin shoqëror”, Logos – A, Shkup, 2012.
2. Kamberi, Ferdi: “Fundamentalizmi i Religjioneve të Mëdha Monoteiste dhe Globalizmi”, Logos – A, Shkup, 2016.
3. Furseth, Inger & Repstad, Pål: “An Introduction to the Sociology of Religion Classical and Contemporary Perspectives”, Taylor & Francis, KIFO, Norway, 2023.
4. Bowie, Fiona: “Antropologjia e Religjionit”, Tabernakul, Prishtinë – Shkup, 2014.
5. Hann, Chris: “Antropologjia Sociale”, Miken, Manastir, 2009.
6. Hjelm, Titus: “Religion and Social Problem”, Routledge, UK, 2011.
7. Freyer, Hans: “Sociologjia e fesë”, Logos – A, Shkup, 2016.
8. Giddens, Anthony: “Sociologjia”, Çabej – Fondacioni Soros, Tiranë, 2004.

LITERATURA SHITESË

1. Hasani, Ismail: “Probleme teorike nga Sociologjia e Religjionit”, Ars Poetika, Prishtinë, 1996.
2. Sarikçioglu, Ekrem: “Historia e Feve – Prej fillimit deri më sot”, Logos – A, Shkup,

2008.

3. Solejmani, Aburrahim: “Fetë e gjalla të Botës”, Instituti për Shkenca Humane Ibn Sina, Prishtinë, 2016.
4. Sinani, Gjergj: “Feja dhe Edukimi”, FES, Tiranë, 2017.
5. Qendra për Studime Humanistike ‘Gani Bobi’: “Interesi Publik dhe Religjioni”, Fondacioni për Shogëri të Hapur, Ferizaj, 2011.

PLANI I DIZAJNUAR I MËSIMIT:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java I	Hyrje, prezantimi i syllabusit, qëllimet dhe synimet
Java II	Ontologjia e religjionit, roli dhe rëndësia
Java III	Teoritë shkencore mbi fenë
Java IV	Totemizmi dhe animizmi, fetë politeiste dhe fetë monoteiste, fetë tjera
Java V	Funksionet e fesë
Java VI	Magjia dhe kultet në Evropë
Java VII	Religjioni, kultura dhe mjedisi social
Java VIII	<i>Kollektivum</i>
Java IX	Përkatësia gjinore dhe feja
Java X	Konflikti dhe feja
Java XI	Nacionalizmi dhe feja – Rastet në Evropë
Java XII	Fundamentalizmi fetar, radikalizmi, ekstremizmi dhe terrorizmi
Java XIII	Shekullarizmi, lacizmi dhe sekularizmi
Java XIV	Organizatat fetare, toleranca dhe diversiteti fetar – Modelet bashkëkohore në Evropë
Java XV	Feja dhe shqiptarët

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar:

- Të respektojë orarin e ligjëratave dhe të jenë të vëmendshëm në orën mësimore;
- Të iu përmbahen të gjitha rregullave edukativo-arsimore;
- Të jetë të përgatitur për ligjëratë duke qenë të pajisur me librin përkatës dhe fletoren për shënime;
- Që në respekt të kolegëve të tyre studentë t’i ndalojnë telefonat personal gjatë mësimt;
- Të jenë pjesëmarrës aktiv në ligjërata;

Studenti është i obliguar të paraqes dhe posedoj ID kartelën në kollektivum dhe provime përfundimtare.

Shënim:

Pjesëmarrja është parakusht për studentët që dëshirojnë të fitojnë njohuri të duhur të këtij subjekti. Studentët që ndjekin rregullisht kursin do të jetë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, duke dhënë kontributin e tyre konkret gjatë ligjëratave interaktive dhe gjatë ushtrimit. Kjo do të ndikojë që të pasurojnë dijen e tyre rreth modulit dhe të arrijnë rezultate më të mira.